

**VENDIM**  
**Nr. 119, datë 24.5.2022**

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “IRARBA ENERGJI” SHPK PËR  
TRANSFERIMIN E ASETEVE TË PALUAJTSHME NË FAVOR TË BANKËS SË  
BASHKUAR TË SHQIPËRISË SHA**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 20, germa “a”, dhe nenit 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të pikës 1.3 dhe pikës 1.6, të “Kushteve të licencës së veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 99, datë 17.6.2016; të nenit 11 të “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 119, datë 21.7.2016; si dhe të nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 24.5.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 771 prot., datë 17.5.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Irarba Energji’ sh.p.k. për transferimin e aseteve në favor të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë sh.a.”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 225, datë 9.11.2021, vendosi të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Irarba Energji” sh.p.k. për transferimin e aseteve të paluajtshme në favor të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë (*United Banka of Albania*) sh.a.

- ERE njoftoi shoqërinë për vendimmarrjen e mësipërme me shkresën nr. 1012/2 prot., datë 10.12.2021, duke evidentuar dhe dokumentacionin e munguar apo të plotësuar pjesërisht.

- Nga analiza që iu bë dokumentacionit të depozituar në ERE në zbatim të “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit”, rezulton se ai është plotësuar si vijon:

Neni 7, pika 1, germat: “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”, “i”, “j”, pika 3, pika 4 dhe pika 6.

- Në lidhje me dokumentacionin e plotësuar pjesërisht, i cili është si vijon:

Neni 7, pika 1, germa “h” (marrëveshje paraprake e nënshkruar midis palëve në një nga format e parashikuara nga ligji, për transferimin e aseteve. Marrëveshja duhet të përmbajë një listë të detajuar të aseteve që kërkohet të transferohen). Shoqëria nuk ka depozituar marrëveshje të nënshkruar me bankën, por janë depozituar shkresa të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë sh.a., ku deklarohej se Banka ka miratuar financimin përkatës, por marrëveshja me shoqërinë për vendosjen e barrës siguroese do të nënshkruhet pas marrjes së autorizimit nga ERE, ndaj në këto rrethana vlerësohet që të miratohet kërkesa e shoqërisë “Irarba Energji” sh.p.k. për transferimin e aseteve në favor të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë sh.a., me kusht që brenda 3 muajve nga ky miratim, të depozitojë në ERE marrëveshjen e nënshkruar me Bankën për këtë transferim të aseteve, ku të jetë përfshirë dhe lista e aseteve të paluajtshme, së bashku me vlerën përkatëse të secilit prej tyre, përndryshe autorizimi i ERE-s do të bëhet i pavlefshëm.

- Dhënia e miratimit nga ERE për transferimin e aseteve nuk e çliron shoqërinë “Irarba Energji” sh.p.k. nga detyrimi për të marrë autorizimet/miratimet e organeve të tjera, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.

- Shoqëria “Irarba Energji” sh.p.k. nuk ka detyrime të pashlyera ndaj ERE-s, për sa i përket pagesave të rregullimit.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

**VENDOSI:**

1. Të miratojë kërkesën e shoqërisë “Irarba Energji” sh.p.k. për transferimin e aseteve të paluajtshme në favor të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë sh.a., me kusht që, brenda 3 muajve nga ky miratim, të depozitojë në ERE marrëveshjen e nënshkruar me bankën për këtë transferim të aseteve, përfshirë dhe lista e aseteve të paluajtshme, së bashku me vlerën përkatëse të secilit prej tyre.

2. Mosdepozitimi i dokumentacionit sipas përcaktimeve të pikës 1, e bën këtë miratim të pavlefshëm.

3. Dhënia e miratimit nga ERE për transferimin e aseteve nuk e çliron shoqërinë “Trarba Energi” sh.p.k. nga detyrimi për të marrë autorizimet/miratimet e organeve të tjera, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.

4. Ky vendim është objekt rishikimi në çdo kohë nga ERE.

5. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara.

Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR**  
**Petrit Ahmeti**